

Kukesi/ Shensoi flet per here te pare si treneri nenkampioneve

nga AlbaniaSoccer

E premte, 04 Tetor 2013 18:52



Kukesi ka marre nje trener te ri ne skuader dhe tani eshte gati te provoje fitoren e pare me Shensoin ne krye. Ndeshja e rradhes per Kukecin si per ironi te fatit do te luhet ne Ballsh ndaj Bylisit qe Shensoi ka drejtuar. Megjithate, tekniku kosovar flet me optimizem perpara ketij takimi qe eshte dhe debutimi tij. “Na duhet te gjejme besimin e humbur. Ketu eshte bere nje pune e mire dhe ish trajneri Cungu meriton respekte maksimale. Kukesi ka lojtare te mire dhe ne do te provojme te marrim vetem fitoren ne Ballsh. Ne synojme titullin dhe une per kete kam ardhur ketu”, ka deklaruar Naxhi Shensoi. Kukesi ne 6 ndeshjet e para ka grumbulluar vetem 7 pike dhe eshte i pozicionuar ne vendin e 9 te tabelës se renditjes .